



Funded by the  
European Union

**Autoriteti Kontraktor: Bashkia Përmet**

**Projekti "Key People-Key Knowledge"**  
Kontrata e grantit IPA/2022/434-967

Udhëzime për aplikantët e sub-granteve

Referenca: **IPA/2022/434-967/GRANTS/1**

### **PYETJE DHE PËRGJIGJE:**

#### **1.Përsa i përket bashkëfinancimit është i detyruar?**

Jo, nuk jeni të detyruar të keni bashkëfinancim.

#### **2.Nuk jam biznes ekzistues, formularin e identifikimit financiar duhet ta plotësoj me të dhënat e llogarisë sime.**

Individët do ta dërgojnë atë pas regjistrimit të bizneseve dhe hapjes së një llogarie bankare për biznesin e ri.

#### **3.Masa e bashkëfinancimit a ndikon në vlerësimin e projekt propozimit?**

Jo, nuk ndikon. Vlerësimi kryhet sipas kritereve të përcaktuara në seksionin 2.3. të udhëzuesit për aplikantët.

#### **4.Duhet të dorëzojmë dokumente të tjera mbështetëse për pagesën e të gjitha detyrimeve fiskale dhe tatimore?**

Dokumentat e vetme që duhet të dorëzoni janë:

1. Formulari i aplikimit të projektit (Shtojca A) në gjuhën shqipe.
2. Buxheti i projektit (Shtojca B) në gjuhën shqipe.
3. Deklarata e aplikuesit (Shtojca C) në gjuhën shqipe.

4. Formulari i entit ligjor i plotësuar dhe nënshkruar detyrimisht nga aplikanti shoqëruar me dokumentet justifikuese të kërkuara aty (kopje e kartës së identitetit ose ekstraktit historik të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit me datë pas datës së hapjes së thirrjes/ Aneksi D) në gjuhën angleze.
5. Një formular identifikimi financiar i aplikantit, në rastin kur është një biznes i regjistruar. Individët do ta dërgojnë atë pas regjistrimit të bizneseve dhe hapjes së një llogarie bankare për biznesin e ri. Kjo bankë duhet të jetë në vendin ku është themeluar aplikanti (Shtojca E) në gjuhën angleze.
6. Deklaratë e nderit (Shtojca H) në gjuhën angleze.

#### **5.Ka ndonjë limit për vlerën e bashkë financimit.**

Nuk ka limit për % e bashkëfinancimit.

#### **6.A mund të vendoset TVSh si bashkëfinancim?**

TVSh është kosto e palejueshme, si rrjedhim nuk mund të vendoset si bashkëfinancim.

#### **7.Afati për dorëzimin e aplikimeve është 19.07.2024 ora 14:00. Edhe nëse e dërgoj me postë duhet të jetë para orës 14:00.**

Nëse aplikimi dorëzohet me postë, aplikimi duhet të dërgohet përpara datës së fundit të aplikimit, siç evidentohet nga vula e dorëzimit në zyrën postare, pra rëndësi ka data jo ora.

#### **8.Projekti është me parafinancim apo pasfinancim?**

Financimi do të bëhet me këste dhe do të jetë me parafinancim. Këstet e pagesave përcaktohen në kontratën e grantit.

#### **9.A janë tarifatat bankare kosto të lejueshme në këtë thirrje ?**

Kostot bankare të hapjes dhe mirëmbajtjes së llogarive bankare janë kosto të lejuara, ndërsa komisionet për transfertat bankare nuk njihen si shpenzim i lejuar.

#### **10. Nuk do ishte më mirë ta shprehim buxhetin në lekë, meqë edhe granti do na transferohet në lekë dhe jo euro.**

Buxheti juaj duhet të shprehet në Euro dhe kontrata me autoritetin grantdhënës do të lidhet me po të njëjtën monedhë. Çështja e kursit të këmbimit do të adresohet në fazën e nënshkrimit të kontratës së grantit.